



K.DH.SH.II.nr.234/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH “Aditex” me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Berat Tmava avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.A., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.198/22 të datës 20.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit Komuna e Prizrenit, e datës 28.12.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.198/22 të datës 20.11.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar në pikën I. të dispozitivit, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit NTSH “Aditex” me seli në Prizren. Në pikën II. Anulohet vendimi nr.001-361-0013939 i datës 16.05.2019 i nxjerr nga Komisioni i Ankesave në Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe çështja i kthehet të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje. Në pikën III. Secila pa i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditurit, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të cenimeve të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar, përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovohet ankesa e parashtruar nga e paditura Komuna e Prizrenit si e bazuar, të refuzohet, padia e paditësit si e pa bazuar apo të ndryshohet aktgjykimi KA.nr.198/22 i datës 20.11.2023 i nxjerrë nga Gjykata Komerciale Prishtinë ose aktgjykimi i ankimuar të priset, çështja ti kthehet Gjykatës-Dhomës së Shkallës së Parë në rigjykim

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin, nr.001-361-0013939 të datës 16.05.2019, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet ankesa e parashtruesit NTSH “Aditex” nga Prizreni lidhur me vlerësimin që është bërë nga ana e Komisionit për Dhënien e Pronës Komunale në shfrytëzim dhe atë dhënien e lokalit me qira në bazë të njoftimit-listës përfundimtare të datës 17.01.2019. Në pikën II. Të obligohet komisioni komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim që të bëjë rishqyrtimin e procesit të ankandit publik gjegjësisht ankesës së parashtruar nga ana e ankuesit të përmendur si në pikën I të këtij dispozitivi në afatin e paraparë ligjor.

Kundër vendimit të paditurit, paditësi inicion konflikt administrativ, me padi i drejtohet gjykatës. Dhoma e Shkallës së Parë, në këtë çështje juridike administrative, me dt. 07.11.2023, mban seancë të shqyrtimit kryesor në mungesë të përfaqësuesit të paditësit e në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, anulon vendimin e organit të paditur, dhe çështjen e kthen te organi i paditur në rishqyrtim dhe rivendosje. Me arsyetim se gjykata me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me padi iu referua nenit 4 par. 1 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Gjykata vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit për anulimin e vendimit kontestues

pasi që gjeti se i padituri në procedurë administrative ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me rastin e vendosjes me vendimin nr.001-361-0013939 të datës 16.05.2019, e pastaj vetë komisioni i ankesave me vendimin nr. 001-361- zyrtar të datës 02.07.2019 e ka anuluar vendimin e vet të datës 24.06.2019 kështu duke lënë pa vendosje meritore lidhur me ankesën që paditësi e ka ushtruar ndaj vendimit të Komisionit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim. Gjykata vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrativ e bëri në përputhje me nenin 48 të LPPA i cili përcakton se “arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptoj aktin administrativ. Arsyetimi përmban 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës, 1.2 shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marr vendimi, 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, 1.6 në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim, 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm i paqartë kundërthënës apo i pa kuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, “Si dhe nenit 52 par.1 nën par. 1.3 dhe 1.4 i LPPA përcakton se “1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse ...1.3 është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative, 1.4 është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”. Gjykata vlerëson se organi administrativ, me rastin e rivendosjes duhet të marr parasysh të gjitha pretendimet e paditësit dhe të hartoj vendimin lidhur me ankesën e paditësit në përputhje me dispozitat e lartcekura. Në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh në ri procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe ti mënjanoj të metat lidhur me vendimin kontestues, ashtu që të trajtoj ankesën e paditësit dhe të shqyrtoj pretendimet e paraqitura në ankesë lidhur me Njoftimin mbi shpalljen e fituesve në tenderin publik të mbajtur me datë 26.12.2018.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor konkludimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale me anulimin e vendimit të ankimuar me padi, sepse i njëjti nuk është i plotë dhe përmbajtjesor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 44 të LKA, sepse është i përfshirë me të meta esenciale. Organi i paditur është dashtë që duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të nxjerr vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me nenet 84 par.2 dhe 85, të

LPA-së, i cili do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjen faktike të çështjes, bazuara në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ deklarimin bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Arsyetimi të jetë i qartë dhe i argumentuar lidhur me mënyrën e vendosjes ashtu si parashihet në nenin 85 të LPA, kur me akt, kufizohen mohohen, shuhen apo preken interesat ligjore ose, vendosen detyrime apo ndëshkime. Nga këto fakte rezulton se i padituri me mënyrën e vendosjes ka nxjerrë vendim jo të drejtë dhe jo ligjor ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPA-së. Andaj, kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë ka vendosur kur e aprovon kërkesëpadinë e paditësit dhe çështjen e kthen te e paditura në rishqyrtim dhe rivendosje vendimin e organit administrativ si në vështrim të nenit 13 par. 1 nën par 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Sa i përket pretendimeve ankimore Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka dhënë arsye mbi faktet vendimtare, pretendimet e dhëna janë të pamjaftueshme nuk jepet analizë e mjaftueshme lidhur me provat e vlerësuara dhe të administruara, nuk ka dhënë arsyetim të formuluar qartë se në cilat prova dhe fakte është bazuar me rastin e zgjedhjes së kësaj çështje. Kolegji vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e Dhomës së Shkallës së Parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë është në pajtim me dispozitat ligjore. Sepse, nuk është kontestuese se vendimi i organit të paditur nuk është përmbajtjesor ashtu si parashihet me dispozitat e cituara si më lartë të LPA-së. Sipas vlerësimit të kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të një pas njëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.234/24, me datë 19.04.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri